

Natyrish, arma e vetme në dispozicion e KOMRA-së është numri sa më i madh i njerëzve në shenjë përkrahjeje të kësaj Initiative.

Deklaratë: Besim Hoda, Lëvizja e qytetarëve EC, Gostivar, Maqedoni, Konsultimet rajonale me shoqërinë civile, Shkup, Maqedoni, 3 qershor, 2010.

Bashkimi Evropian mund ti detyrojë qeveritë t'i gjejnë personat e zhdukur.

(...) na duhet përkrahja e Bashkësisë Evropiane, posaçërisht ti detyrojë qeveritë e të gjitha shteteve për zbulimin e personave të zhdukur.

Deklaratë: Armend Mazreku, Lëvizja Fol, Prishtinë, Kosovë, Konsultimet rajonale me shoqërinë civile, Shkup, Maqedoni, 3 qershor, 2010.

Iniciativa për KOMRA-në është fisnike.

(...) tani e kam më të qartë se çka dëshironi të arrini me këtë iniciativë, po, pajtohem me këtë iniciativë fisnike.

Deklaratë: Oliver Bacanoviq, Fakulteti për siguri, Shkup, Maqedoni, Konsultimet rajonale me shoqërinë civile, Shkup, Maqedoni, 3 qershor, 2010.

Duhet të ndryshohet legjislacioni penal, që të harmonizohet me KOMRA-në.

(...) këtë duhet ta shikojmë nga aspekti që do të jetë e nevojshme në periudhën e implementimit, madje edhe para, të ndryshohet legjislacioni i caktuar i cili ka të bëjë me përgjegjësinë e krimit, do të thotë legjislacioni penal (...) nëse vërtetohet se dikush ka kryer veprë penale, qartë se vjen deri të individualizimi i përgjegjësisë së tij, dhe si, në çfarë mënyre të delegohet kjo te institucionet ligjore, prokuroritë, policia.

Deklaratë: Milena Saviq, CIPP, Zvornik, BeH, Konsultimet rajonale me shoqërinë civile, Shkup, Maqedoni, 3 qershor, 2010.

KOMRA me rekomandimet e saj duhet të ndikoj në ndryshimin e sistemit arsimor. Dëgjimet publike do të çojnë në ndjeshmëri kolektive.

(...) komisioni (...) ka përgjegjësi shumë të madhe që me kualitetin e saj dhe me rekomandimet e hollësishme, para se gjithash të ndikojë në kahjen e ndryshimit të sistemit të arsimit. Pra, të sistemit të arsimit zyrtar që vepron, pra sipas të cilit do të arsimohen gjeneratat e ardhshme. Dhe mendoj, se këto dëgjimet /seancat publike të cilat janë paraparë (...) do të çojnë në ndjeshmëri kolektive.

Deklaratë: Ivan Novosel, Legalis, Zagreb, Kroaci, Konsultimet rajonale me shoqërinë civile, Shkup, Maqedoni, 3 qershor, 2010.

100. Konsultimet nacionale me komunitetin fetar mbi iniciativën për themelimin e KOMRA-së

**Prizren, Kosovë
29. korrik 2010.**

Konsultimet i organizoi Fondi për të Drejtën Humanitare. Në takim morën pjesë 46 pjesëmarrës/e – përfaqësues të Bashkësisë Islame, Kishës Katolike, Kishës Ortodokse Serbe dhe Kishës Protestante Evangjeliste. Moderator i takimit ishte Bekim Blakaj (Fondi për të drejtën Humanitare), ndërsa fjalën hyrëse e mbajtën Veton Mujaj (Syri i Vizionit, Pejë, Kosovë), Natasha Kandiç (Fondi për të Drejtën Humanitare) dhe Ismail Hasani, sociolog i religjionit nga Prishtina. Në fillim të takimit, pjesëmarrësve iu drejtua Ruzhdi Rexha, nënkryetar i Komunes së Prizrenit, i cili e mbështeti Iniciativën për KOMRA-në. Gjashtë shtëpi televizive njoftuan dhe raportuan për konsultimet - RTV Besa, TV Prizreni, Koha Ditore, Televizioni i Kosovës, Radio Kosova dhe KTV.

Përfaqësuesit e komunitetit fetar duhet ti mbështesin viktimat, e jo ti keqpërdorin.

(...) i ftoj përfaqësuesit e komunitetit fetar që të mos e lëshojnë rastin dhe të tregojnë se në Ballkan, në këto koordinata gjeografike të Evropës ekzistojnë njerëz të cilët duan dhe munden (...) të ballafaqohen me realitetin, me atë se çfarë ka ndodhë dhe të mos i shfrytëzojnë (abuzojnë) viktimat e luftërave prej viteve të '20-ta e këndej, vetëm për arsye të interesave të tyre personale gjatë kohës së festave të ndryshme fetare, përvjetorëve të ndryshëm, por t'u dëshmojmë viktimave se i përkrahim në mënyrë të hapur.

Deklaratë: Ismail Hasani, sociolog i religjionit, Prishtinë, Kosovë, Konsultimet Nacionale me komunitetin fetar mbi iniciativën për KOMRA-në, Prizren, Kosovë, 29. korrik 2010.

Ekziston nevoja për dëgjime publike. Kështu do ta mësojmë të vërtetën.

E përkrahi zonjën Kandiç dhe iniciativën, sepse ekziston nevoja për dëgjime publike, njerëzit kanë nevojë që të tregojnë, dhe nga kjo as komuniteti fetar e as komunitetet etnike apo asnjë popull nuk do të humbë asgjë, vetëm se do të qetësoheshim dhe do ta shikonim situatën në sy, do të njoftojmë realitetin ashtu si është.

Deklaratë: Ramadan Shkodra, Kryesia e Bashkësisë Islame, Prishtinë, Kosovë, Konsultimet Nacionale me komunitetin fetar mbi iniciativën për KOMRA-në, Prizren, Kosovë, 29. korrik 2010.

Iniciativa për KOMRA-në është shumë e rëndësishme.

Në emër të Këshillit të Lartë të Bashkësisë Islame, ju përcjellë përshëndetjet nga myftiu i respektuar dhe të të gjithë udhëheqësis së bashkësisë islame me mbështetjen për KOMRA-në, e cila vërtetë është iniciativë shumë e rëndësishme.

Deklaratë: Fitim Flugaj, Kryesia e bashkësisë islame, Prishtinë, Kosovë, Konsultimet Nacionale me komunitetin fetar mbi iniciativën për KOMRA-në, Prizren, Kosovë, 29. korrik 2010.

Iniciativa për KOMRA-në mund ta zgjojë ndërgjegjen e shoqërisë.

Besoj se iniciativa mund tu ndihmojë bashkësive fetare, shoqërisë, të gjithëve së bashku, që ta zgjojë ndërgjegjen e shoqërisë. Në Bibël qëndron thënia: „Do ta njoftoni të vërtetën pas së cilës do të ndjeheni të lirë! E vërteta do t’ju liroj! Askush nuk duhet t’i frikohet të vërtetës. Vërtetë, vetëm gënjeshtria duhet ti frikohet të vërtetës. (...) Nuk duam të jemi vetëm përkrahës të iniciativës, duam të jemi pjesë aktive e saj.

Deklaratë: Artur Krasniqi, kryetar i Kishës Protestante Evangjeliste të Kosovës, Prishtinë, Kosovë, Konsultimet Nacionale me komunitetin fetar mbi iniciativën për KOMRA-në, Prizren, Kosovë, 29. korrik 2010.

Të gjitha bashkësitë fetare, unanimitisht të distancohen nga ngjarjet të cilat kanë çuar deri te lufta, dhe ti gjykojnë ato, e pastaj të gjitha së bashku të favorizojmë bashkëjetesën ndëretnike dhe ndërfetare.

(...) ne sërish dhe haptazi po dëshmojmë se Kisha Katolike është e gatshme për dialog, si çdo herë gjatë historisë, por shprehim që përmes këtyre iniciativave, forumeve të vijmë deri te bashkimi dhe njëzëri të gjitha bashkësitë fetare të distancohen nga ngjarjet të cilat kanë çuar deri te lufta, dhe njëzëri ti gjykojnë ato, dhe pastaj së bashku ta favorizojmë bashkëjetesën ndëretnike dhe ndërfetare.

Deklaratë: Don Pal Tunaj, Kisha Katolike në Kosovë, Pejë, Kosovë, Konsultimet Nacionale me komunitetin fetar mbi iniciativën për KOMRA-në, Prizren, Kosovë, 29. korrik 2010.

Bashkësitë fetare duhet t’i inkurajojnë viktimat të dëshmojnë për krimet.

(...) ne si bashkësi (komunitete) fetare duhet të jemi ana e fortë e iniciativës dhe ti shfrytëzojmë potencialet dhe ndikimin tonë të viktimat dhe ti inkurajojmë që të dëshmojnë për krimet të cilat janë kryer ndaj tyre.

Deklaratë: Rexhep Lushta, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Mitrovicë, Kosovë, Konsultimet Nacionale me komunitetin fetar mbi iniciativën për KOMRA-në, Prizren, Kosovë, 29. korrik 2010.

Nuk e kam te qartë definicionin për viktimën. Nuk duhet të ketë barazi të viktimave dhe agresorit.

(...) nuk e kam krejtësisht të qartë definicionin për viktimat, kush është viktimë, për arsye se kjo mënyrë thërret për paqe, sikurse po na barazon me agresorin apo iniciuesin e luftës. Mendoj se këtë duhet sqaruar, sepse nuk do të arrijmë kurrfarë suksesi poqëse ne duhet vetëm të falim.

Deklaratë: Nysret Abazira, Këshilli i Lartë i Bashkësisë Islame, Rahovec, Kosovë, Konsultimet Nacionale me komunitetin fetar mbi iniciativën për KOMRA-në, Prizren, Kosovë, 29. korrik 2010.

Teologët duhet ti përcjellin mesazhet për pajtim.

(...) pasi që jemi shërbëtorë të Perëndisë, si teologë të feve të ndryshme, duhet ti përcjellim mesazhet e paqes, çdo herë në to të flitet e vërteta, duhet të besojmë në atë që e themi dhe të angazhohemi në atë drejtim.

Deklaratë: Ajni Sinani, teolog në Universitetin Islam, Kosovë, Konsultimet Nacionale me komunitetin fetar mbi iniciativën për KOMRA-në, Prizren, Kosovë, 29. korrik 2010.

Në mandatin e KOMRA-së duhet të jetë edhe diskriminimi.

Në fillim të viteve të '90-ta, më ka ndodhë një pakënaqësi. Fillova të ndjejë ndjenjën e diskriminimit. Mendoj se kjo është një ndjenjë e veçantë, dhe tërë kjo, në të gjitha materialet të cilët i kam lexuar me kujdes, askund nuk është përmendur diskriminimi, (...) Diskriminimi në radhë të parë në ndarjen e fëmijëve (...) Diskriminimi ka ekzistuar edhe të ndarja e pagave të mësimdhënësve, në rastin kur Zhivana, arsimtare e gjuhës angleze siç jam edhe unë, ajo e ka pagën dy herë më të lartë se unë.

Deklaratë: Greta Kaçinari, Kisha Katolike në Kosovë, Kosovë, Konsultimet Nacionale me komunitetin fetar mbi iniciativën për KOMRA-në, Prizren, Kosovë, 29. korrik 2010.

Nëse flasim për përgjegjësinë, duhet të fillojmë nga vetja, e jo ta drejtojmë gishtin drejt të tjerëve.

(...) nëse duhet të flasim për përgjegjësinë, duhet të fillojmë nga vetja, e jo ta drejtojmë gishtin drejt të tjerëve, sepse gjykimi i të tjerëve, nëse nuk merremi me të metat tona, është shkaktari kryesorë i urrejtjes dhe konfliktit.

Deklaratë: Monarku Nifont, Kisha Ortodokse serbe, manastiri i Deçanit, Kosovë, Konsultimet Nacionale me komunitetin fetar mbi iniciativën për KOMRA-në, Prizren, Kosovë, 29. korrik 2010.

E përkrahim iniciativën për KOMRA-në.

I falënderohemi organizatorit për nismën e kësaj iniciative shumë të rëndësishme, dhe ne gjithsesi do të angazhohemi që të japim mbështetjen tonë në të gjitha vazhdimet konkrete të këtij projekti.

Deklaratë: Monarku Nifont, Kisha Ortodokse serbe, manastiri i Deçanit, Kosovë, Konsultimet Nacionale me komunitetin fetar mbi iniciativën për KOMRA-në, Prizren, Kosovë, 29. korrik 2010.

Mandati i KOMRA-së duhet të përfshijë edhe torturat psikologjike.

Dëshiroj të japë edhe një sugjerim, e kjo është: të radhitet në llojet e lëndimeve, të cilat janë paraparë sipas mandatit (kompetencës) së KOMRA-së, edhe tortura psikologjike, së cilës i kanë qenë të nënshtruara viktimat e ndryshme në luftërat e ndryshme.

Deklaratë: Liridon Kadriu, aktivist i Bashkësisë Islame në Kosovë, Prishtinë, Kosovë, (Monarku Nifont, Kisha Ortodokse serbe, manastiri i Deçanit, Kosovë, Konsultimet Nacionale me komunitetin fetar mbi iniciativën për KOMRA-në, Prizren, Kosovë, 29. korrik 2010.

Çfarë mund të bëjmë ne konkretisht për iniciativën?

Çfarë mund të bëjmë ne konkretisht, e pyes zonjën Kandiç? Poqëse keni instruksione për 20-30 veta, dhe nëse secili e kryen punën e tij, do ti kemi 30 punë, nga dhjetë angazhime pune do të jenë 300, pra na jepni diçka konkrete të bëjmë.

Deklaratë: Ramadan Shkodra, Kryesia e Bashkësisë Islame, Prishtinë, Kosovë, (Monarku Nifont, Kisha Ortodokse serbe, manastiri i Deçanit, Kosovë, Konsultimet Nacionale me komunitetin fetar mbi iniciativën për KOMRA-në, Prizren, Kosovë, 29. korrik 2010.

101. Konsultimet Rajonale me intelektualët mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së

**Banja Llukë, BeH
4. shtator 2010.**

Konsultimet i organizuan Shoqata e gazetarëve të BeH dhe Qendra Informativë –për ndihmë juridike nga Zvorniku. Morrën pjesë gjithsejt 42 pjesëmarrës-e dhe mysafirë. Moderator ishte Lazar Stojanov (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi). Për konsultimet raportuan TV BH, Gazetat e pavarura, ONASA dhe BHRT-HT 1. Para konsultimeve u mbajt debati televiziv në ATV, në të cilin morrën pjesë Arsim Gërgjalu (Kosovë), Sllavko Kukiq, Ismet Sejfića, Mladen Miroslavleviq, Srgjan Puhalo (BeH), Zharko Puhovski (Kroaci), Zhelimir Zhilininik dhe Lazar Stojanov.

Mediat, në përkrahje të Iniciativës për KOMRA-në, u ndanë në përputhje me ndikimin të cilin politikanët e kanë në ta.

Mediat, në përkrahje të kësaj Iniciative, u ndanë në përputhje me ndikimin politik të cilin e kanë në ta politikanët e caktuar.

Deklaratë: Gjenana Karup-Drushko, koordinatore e procesit konsultativ të Iniciativës për KOMRA-në, BeH, Konsultimet Rajonale me intelektualët mbi Iniciativën për KOMRA-në, Banja Llukë, BeH, 4 shtator, 2010.

Për disa politikanë, KOMRA nuk është e nevojshme, sepse nuk duan të ballafaqohen me të kaluarën.

Pse disa politikanë mendojnë se kjo nuk na duhet? Përgjegjja e vetme (...) është se ata njerëz nuk duan të ballafaqohen me të kaluarën, atyre u duhet nacionalizmi.

Deklaratë: Gjenana Karup-Drushko, koordinatore e procesit konsultativ të Iniciativës për KOMRA-në, BeH, Konsultimet Rajonale me intelektualët mbi Iniciativën për KOMRA-në, Banja Llukë, BeH, 4 shtator, 2010.

Duhet të bëhet hulumtimi për perceptimin e Iniciativës për KOMRA-në në publik.

(...) a është bërë hulumtimi lidhur me perceptimin në media (...) tani është çështje tjetër se a është negative, pozitive, etj. Por edhe kjo është një e dhënë, sepse nëse është negative, do ta dimë se si të ndikojmë dhe ta ndryshojmë atë perceptim në kuptim pozitiv. Për këtë mendova.

Deklaratë: Mladen Miroslavleviq, profesor, Fakulteti NUBL, Banja Llukë, BeH, Konsultimet Rajonale me intelektualët mbi Iniciativën për KOMRA-në, Banja Llukë, BeH, 4 shtator, 2010.

Nuk është bërë hulumtimi mbi perceptimin për KOMRA-në, por ajo është duke u studiuar me kujdes në artikujt e shtypit.

Ne nuk kemi (...) hyrë në hulumtim, sepse kjo gjë është shumë e shtrenjtë, ndërsa akcioni është mjaft i shkurtër. Do të thotë se matjen dhe hulumtimin e perceptimit nuk e kemi bërë, megjithatë ne shumë detalisht, i kemi personat për këtë, i studiojmë artikujt në shtyp për ne, dhe për to ne e kemi analizën e përmbajtjeve të tyre, kështu që ne ato i numërojmë dhe i përcjellim, por të jem i saktë ne ato nuk i masim, unë nuk pres që për shtatë muaj, sa jemi duke punuar, ti kryejmë ato, por kemi indikacione shumë të qarta se a po na dobësohet imazhi apo prishet.

Deklaratë: Lazar Stojanoviq, PR rajonal dhe drejtor i kampanjës për media të Iniciativës për KOMRA-në, Serbi, Konsultimet Rajonale me intelektualët mbi Iniciativën për KOMRA-në, Banja Llukë, BeH, 4 shtator, 2010.